



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2016
Nr. Dok. 201601990/4

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave përkatëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për kthimin në punën e mëparshme të shtetases R. T. nga qyteti i Durrësit.*

Drejtuar : **Z.Gazmir TAHIRI**
Drejtor i Përgjithshëm i Porteve

DURRËS

Zj.Albana KOÇIU
Drejtoresh Departamentit të Administratës Publik

Për dijeni : **Zj.JULIANA HOXHA**
Sekretare e Përgjithshme
MINISTRIA E DREJTËSISË

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Në ankesën e saj të përsëritur drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetësja R. T. nga qyteti i Durrësit, ankohet se ka punuar pranë Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve Durrës dhe me vendimin Nr.173 prot datë 22.05.2006, kërkueses i janë ndërprerë marrdhëniet financiare dhe është liruar nga detyra. Megjithatë disponon vendimet gjyqësore të formës së prerë, për rikthim në punën e mëparshme akoma nuk po rikthehet në detyrën e saj dhe për këtë ajo ka kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit tonë për zgjidhjen e këtij problemi në bazë të legjislacionit në fuqi.

Ndaj kësaj mase disiplinore të largimit nga puna ankuesja R. T. është ankuar në bazë të dispozitave të Kodit Punës në rrugë gjyqësore në Gjykatë, dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e saj Nr.2918 datë 12.12.2006, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të zgjidhjes së kontratës së punës mes Kapitenerisë së Porteve Durrës dhe kërkueses, detyrimin e Palës së Paditur për rikthimin në punë të paditëses dhe pagimi e pagës së saj për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë duke filluar nga data 31.05.2006 e deri në ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor.

Mbi ankimin e palëve Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e saj Nr.540 datë 03.12.2007 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe në zbatim të tij

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka nxjerr urdhërin e ekzekutimit me Nr.36 datë 21.01.2008.

Në këto kushte ankuesja R. T. vendimin gjyqësor të formës së prerë së bashku me urdhërin e ekzekutimit i ka vënë në ekzekutim në Zyrën Përmbartimore Durrës me datën 07.04.2008, e cila megjithë përpjekjet e saj nuk ka bërë të mundur ekzekutimin plotësisht të tyre me arsyetim se vendi i saj i punës nga Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, është suprimuar.

Duke kaluar një kohë e gjatë dhe duke mos u rikthyer në punën e mëparshme ankuesja R. T. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e saj Nr.4 datë 20.02.2013 ka vendosur konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë Nr.540 fatë 03.12.2007, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Edhe pas kësaj vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar dhe ankuesja R. T. i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila me vendimin e saj me Nr.38964/13 "**Çështja T. kundër Shqipërisë**", e cila ka vendosur pranimin e kërkesës së ankueses R. T.

Pas vendimit të GJEDNJ me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr.650 datë 22.07.2015, është vendosur ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për ekzekutimin e tij është ngarkuar Departamenti i Administratës Publike dhe Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Durrës, por përsëri ankuesja R. T. nuk është rikthyer në punën e saj të mëparshme, në bazë të disponimit të vendimeve gjyqësore.

Duke analizuar me kujdes këtë rast, mendojmë se ai duhet konsideruar nga ana juaj si një rast i veçantë dhe jo i zakonshëm pasi ky rast ka lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore, respektimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe garantimin e të drejtës së sigurisë juridike të shtetasve, si parime të rëndësishme të shtetit të së drejtës.

Ashtu sikundër është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës, është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (KEDNJ).

Në vendimmarrjen e saj Gjykata Kushtetuese ka pranuar se "...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor për të cilin bën fjalë në nenin 42/2 të Kushtetutës së RSH dhe neni 6 i KEDNJ, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuar nga neni 142/3 të Kushtetutës së RSH, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një Gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj.

Më tej, Gjykata ka pranuar se "...ekzekutimi i vendimit në vetvete përbën një elementë thelbësor të shtetit të së drejtës e të vet nocionit të gjykimit të drejtë .Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre.

Në lidhje me qëndrimin tuaj në përgjigjen e dërguar me shkresën Nr.2139/1 dtatë 24.05.2016, se ju i keni propozuar ankueses R. T. sistemim

si "Specialiste Finance në Drejtorinë e Bujqësisë Durrës, për mendimin tonë nuk është qëndrim i drejtë dhe i bazuar në ligj pasi ankuesja R. T. nuk është dakord dhe ajo nuk e ka fituar akoma statusin e nënpunësit civil sipas kërkesave të Ligjit Nr.152/2013 dt.30.05.2013, ndryshuar me Ligjin Nr.178/2014" Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.152/2013 "Për Nënpunësin Civil", dhe për rrjedhojë ajo duhet të trajtohet nga nga juaj në bazë të kërkesave ligjore të Kodit Punës dhe të legjislacionit në fuqi në atë kohe, duke marrë masa me çdo kusht për sistemimin e saj në punën e mëparshme në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Në nenin 1/2 të Ligjit Nr.152/2013 thuhet se ligji rregullon marrdhëniet juridike ndërmjet shtetit dhe N/C dhe përcakton rregullat për administrimin e shërbimit civil. Ky ligj zbatohet për çdo N/C që ushtron një funksion në një institucion të administratës shtetërore. Në nenin 7 të ligjit thuhet se DAP mbikqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore.

Për sa më sipër bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të porozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrata publike", në bazë të kërkesave të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se pas përfundimit të hetimit, "Avokati i Popullit paraqet rekomandim për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe të lirive, dhe në nenin 142/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: "Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore" si dhe në VKM Nr.560 datë 22.07.2015,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me Nr.540 datë 03.12.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës, për rikthimin në punën e mëparshme të shtetases R. T. nga qyteti i Durrësit.

2. Mbi masat e marra nga ana juaj për pranimin e këtij rekomandimi, lutemi të na njoftoni me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI